

# Statistikat e Bujqësisë dhe Blegtorisë për vitin 2016


**Tiranë, më 22 Nëntor 2017:** Në vitin 2016 prodhimi i perimeve është 1.129.101, duke shënuar një rritje prej 9,6 %, krahasuar me vitin 2015. Niveli më i lartë i prodhimit të perimeve është në qarqet Fier me 373.406 ton, Tiranë me 121.661 ton dhe Berat me 120.105 ton.

Prodhimi i drithrave, në vitin 2016, është 698.400 ton, duke shënuar një rritje me 0,4 %, në krahasim me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të drithrave u arrit në qarkun e Fierit me 156.530 ton, e pasuar nga qarqet Elbasan me 98.535 ton dhe Korçës me 88.451 ton.

**Tab.1 Prodhimi bujqësor 000/ton**


Prodhimi bujqësor	2013	2014	2015	2016
<b>Bimët e arave</b>				
Drithra	703,0	700,0	695,5	698,4
Perime	924,0	950,0	1030,0	1129,1
Patate	237,0	240,0	245,0	238,3
Fasule	28,0	30,0	28,0	25,0
Bimë industriale	5,0	5,0	4,7	4,5
Bimë medicinale	7,0	17,4	10,8	10,6
Foragjere	6048,0	6100,0	6000,0	6144,0
<b>Drufrutorët</b>				
Pemë frutore	218,0	220,0	245,0	261,0
Ullinj	92,0	98,0	96,0	99,0
Agrume	20,0	21,0	30,0	40,0
Rrush gjithsej	204,0	204,0	205,0	205,1

**Fig. 1 Prodhimi i drithrave, perimeve dhe patates 000/ton**



Në grupin e perimeve peshën më të madhe e zënë perimet e njoma me 65,5 %, të pasuara nga bostanoret me 24,5 % dhe perimet e thata me 10,0 %.

**Fig. 2 Struktura e prodhimit të perimeve**




Numri i rrënjëve të pemëve frutore në prodhim në vitin 2016 është 10.575.000, duke pësuar një rritje me 3,8 %, në krahasim me vitin 2015. Numri i rrënjëve të ullinjëve në prodhim në vitin 2016 është 6.643.000 dhe ka pësuar një rritje 4,9 %, në krahasim me vitin 2015. Numri i rrënjëve të agrumeve në prodhim në vitin 2016 është 1.044.000, duke shënuar një rritje 9,8 %, në krahasim me vitin 2015. Sipërfaqja e vreshtave në prodhim është 10, 011 Ha, duke pësuar një rritje me 1,2 %, në krahasim me vitin 2015.

Prodhimi i pemëve frutore në vitin 2016 është 261.754 ton dhe u karakterizua nga një rritje prej 7,6 %, krahasuar me 2015.

Në vitin 2016 u prodhuan 99.075 ton ullinj duke pësuar një rritje 3,2 %, krahasuar me një vit më parë.

**Fig. 3 Ritmi vjetor i rritjes së prodhimit të pemëve frutore**



Prodhimi i agrumeve në vitin 2016 është 40.000 ton, duke shënuar një rritje prej 33,3 %, krahasuar me një vit më parë. Niveli më i lartë i prodhimit të agrumeve u arrit në qarkun e Vlorës me 23.379 ton.


**Fig. 4 Ritmi vjetor i rritjes së prodhimit të agrumeve**



**Blegtoria**

Numri i gjedhëve në vitin 2016 është 492.393 krerë, duke shënuar një rënie me 2,3 %, në krahasim me vitin 2015. Ndaj totalit të tufës së gjedhit dominojnë lopët e qumështit me 72 %.

**Fig. 5 Struktura e gjedhit sipas qarqeve**



Numri i të leshtave nuk ka patur ndryshime të dukshme në vitet e fundit. Në vitin 2016, numri i të leshtave është 1.971.933 krerë ose 2,8 % më shumë se në vitin 2015. Kategoria kryesore e të leshtave janë delet e qumështit me 72,4 % ndaj totalit të tufës. Qarqet ku është më i përqëndruar mbarështimi i të leshtave është Vlora me 17,3 %, Gjirokastra dhe Fieri me 15 %. Lezha është qarku i cili ka numrin më të vogël të të leshtave, me 1,7 % ndaj totalit të numrit të krerëve në të gjithë vendin.

Në vitin 2016, numri i të dhirtave është 940.806, me një rritje vjetore 0,9 %, në krahasim me vitin 2015. Kategoria kryesore janë dhitë e qumështit, me 76 % ndaj totalit të tufës. Qarqet ku është më i përqëndruar mbarështimi i të dhirtave janë Gjirokastra dhe Elbasani me 15 %, ndërsa Durrësi është qarku i cili ka numrin më të vogël të të dhirtave me 2,3 % ndaj totalit.

Në vitin 2016 numri i krerëve të derrave ka qenë 181.024 krerë, duke shënuar një rritje vjetore me 5,6 % në krahasim me vitin 2015. Përqëndrimi më madh i numrit të krerëve është në Lezhë me 36,2 % dhe Shkodër me 27,7 % ndaj totalit të gjithë krerëve. Qarqet me numrin më të vogël përfaqësues të derrave janë: Vlora dhe Elbasani me 3 %, ndërsa Gjirokastra është qarku më pak përfaqësues me 0,7 %, ndaj totalit të krerëve të derrave në të gjithë vendin.

**Tab. 2 Numri i krerëve të bagëtive në 000/krerë**

Emërtimi	2013	2014	2015	2016
<b>Gjedhë</b>	<b>498</b>	<b>500</b>	<b>504</b>	<b>492</b>
Lopë	356	358	357	355
<b>Të leshta</b>	<b>1.856</b>	<b>1.896</b>	<b>1.918</b>	<b>1.972</b>
- Dele	1.413	1.419	1.417	1.428
<b>Të dhirta</b>	<b>867</b>	<b>904</b>	<b>932</b>	<b>941</b>
- Dhi	656	695	700	716
<b>Derra</b>	<b>152</b>	<b>172</b>	<b>171</b>	<b>181</b>
- Dosa	12	12	11	13
<b>Njëthundrakë</b>	<b>93</b>	<b>91</b>	<b>91</b>	<b>94</b>
- Kuaj	35	32	31	34
<b>Shpendë</b>	<b>8.928</b>	<b>9.493</b>	<b>8.558</b>	<b>8.326</b>
-Pula	5.934	6.645	5.323	4.790
<b>Bletë/koshere</b>	<b>246</b>	<b>261</b>	<b>271</b>	<b>303</b>

Në 2016, prodhimi i qumështit është rreth 1.2 milion ton, duke rritur me 1,2 %, në krahasim me vitin 2015. Prodhimi i mishit peshë e gjallë është 160 mijë ton, duke u rritur me 1,27 %, në krahasim me vitin 2015.

**Tab. 3 Numri i kafshëve të qumështit 000/krerë**

Emërtimi	2013	2014	2015	2016
Lopë	356	358	357	355
Dele	1.413	1.419	1.417	1.428
Dhi	656	695	700	716

**Tab. 4 Prodhimet blegtorale në 000/ton**

Emërtimi	2013	2014	2015	2016
Qumësht	1.131	1.133	1.131	1.145
Mish peshë e gjallë	153	155	158	160
Vezë/milionë kokra	830	835	830	830

# Metodologjia

Informacioni mblidhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit. Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Të dhënat blegtorale grumbullohen për numrin e kafshëve që mbarështojnë fermerët si dhe prodhimet blegtorale. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë të dhëna për të krahasuar dhe me të dhënat e shërbimit veterinar i cili kryen matrikullimin dhe vaksinimin e kafshëve (procesi është në vazhdimësi). Shërbimi veterinar kryen në momentin e vaksinimit inventarin e kafshëve në nivel komune. Specialistët e ekstensionit kanë marrëdhënie dhe me veterinerët privatë. Këta veterinerë kryejnë shërbime të ndryshme në mënyrë private pranë fermerëve (si kontroll nga sëmundjet, ngordhje të kafshëve apo lindje, therje, vaksinime etj). Në fund specialistët e ekstensionit krahasojnë të dhënat nga të tre burimet. Specialistët e ekstensionit grumbullojnë gjithashtu të dhëna për prodhimet bujqësore dhe blegtorale nga fermerët. Të dhëna për rendimentin e prodhimeve grumbullohen nga fermat më përfaqësuese në nivel komune. Të dhënat e grumbulluara dërgohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ku specialistët e prodhimit bimor dhe blegtoral bëjnë vlerësime duke krahasuar të dhënat e grumbulluara nga terreni me të dhënat e fermave në vite.

Ministria e Bujqësisë përdor tre burime informacioni për grumbullimin e të dhënave:

1. Ekspertët e ekstensionit që janë pjesë e strukturave të Drejtorisë së Bujqësisë në rrethe
2. Shërbimin veterinar në rrethe
3. Veterinerët privat

## Përkufizime

**Njësia Ekonomike Bujqësore (NJEB)** - është njësi e vetme, teknike ekonomike, e përcaktuar në një drejtim unik, nga terreni dhe pse në parcela jo të vazhdueshme, në të cilën realizohet prodhimi bujqësor dhe blegtoral që drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, për realizimin e veprimtarive bujqësore – blegtorale.

Njësi ekonomike bujqësore konsiderohen edhe njësitë ekonomike me drejtim të plotë blegtoral, në të cilat arrihet mbarështrimi i kafshëve pa patur në administrim tokë bujqësore, pra ku toka nuk figuron si element përbërës i njësisë.

### **Tokë e punueshme**

Toka e punueshme është toka arë e pluguar ose e lëruar rregullisht, sipas një sistemi të qarkullimit bimor. Sipërfaqja e kultivuar me bimë arash, është sipërfaqja e mbjellë me bimë arash në vitin bujqësor të dhënë. Këtu bëhet fjalë për sipërfaqe me kultura kryesore (të para). Kultura të kryesore janë drithrat e bukës, kulturat e pranverës misri kokërr, patatja, fasulja, bimët industriale, foragjeret shumëvjeçare, etj.

### **Drufrutorët**

Drufrutorët përfaqësohen nga pemët frutore (frutat farore, bërthamore, subtropikale, arvore e tjera), ullinjt, agrumet, vreshtat dhe pjergullat.

### **Vit prodhimi**

Me vit prodhimi nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

### **Sipërfaqja e kultivuar**

Sipërfaqja e kultivuar korespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Nga kjo sipërfaqe cila përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj). Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta.

### **Sipërfaqja prodhuese**

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përjashtohen sipërfaqet e pemtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.

**Blegtoria dhe shpendët** mbulojnë të gjitha kafshët pavarësisht nga mosha e tyre vendndodhja ose qëllimi i tyre për mbarështim. Kafshët mund të jenë prezent në Njësinë Ekonomike Bujqësore, ose jashtë fermave bujqësore në kullotë.

### **Klasifikimi**

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithësej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

Klasifikimi i kafshëve bëhet sipas llojeve (gjedhë, të leshta, të dhirta, derra, kuaj), sipas moshës, seksit dhe destinacionit ekonomik.

Shpendët janë të grupuar në një grup të vetëm dhe përfshihen pulat, pulat afrikane, gjela deti, pata, rosa, etj.

**Rregullat kryesore për grumbullimin e të dhënave**

Numuri i krerëve të blegtoprisë i referohet 1 dhjetor 2016

Fermeri pyetet për të gjitha llojet e kafshëve që ai zotëron

Informacioni grumbullohet vetëm për numurin e krerëve që ka në zotërim njesia ekonomike bujqësore

Të gjitha kafshët e blera nga ekonomi të tjera gjatë vitit numërohen .

Të gjitha kafshët e shitura ekonomive të tjera gjatë vitit nuk numërohen.

Lindjet e blegtorisë janë të lindurit gjatë 12 muajve të fundit. Nuk përfshihet blegtorja e lindur e ngordhur.

Humbjet e kafshëve gjatë vitit, ngordhje, ngrënie nga egërsirat, apo nga shkaqe natyrore nuk numërohen.